



# Lulëzimi i pagave në krizën e çmimeve

## RAPORT MONITORIMI

Maj-Korrik 2023



QENDRESA QYTETARE



NED NATIONAL ENDOWMENT FOR DEMOCRACY SUPPORTING FREEDOM AROUND THE WORLD

[www.qeverisja.qq.com.al](http://www.qeverisja.qq.com.al)

AUTOR  
KOLINDO VJERDHA

## Tabela e përmbajtjes:

1. Hyrje
2. Çfarë është paga minimale?
3. Ecuria e pagës minimale në Shqipëri
4. Vendimi
5. Efektet që pasojnë indeksimin e pagës minimale
  - 5.1 Ndikimi në Buxhetin e Shtetit
  - 5.2 Ndikimi mbi investimet e huaja
6. Numri i të deklaruarve me pagë minimale
7. Ligji i Pagave
8. Faktorët që ndikuan rritjen
9. Efektet reale që sjell
10. Burimet e financimit të reformës për rritjen e pagave
11. Përfundime
12. Rekomandime

## Bibliografia

## Hyrje

Paga është kthyer në kryefjalë jo vetëm në diskurin publik, por edhe si faktor determinant i përcaktimit të nivelit të mirëqënies dhe krijimit të përceptimit mbi pozitat klasore të individit. Shqipëria po përfshihet në një vorbull të re reformash, duke nisur që me rritjen e pagës minimale e deri në një rritje të përgjithshme të nivelit të pagave në sektorin publik. Kjo e fundit nisi të zhvillohej pikërisht pak para fillimit të fushatës zgjedhore të zgjedhjeve vendore, duke u etiketuar si një ndër premtimet bazë të saj, ndonëse kjo e gjitha në kundërshtim të normave etike dhe mungesës së luajalitetit në garë. Një premtim i tillë filloj të materializohet menjëherë pas mbarimit të zgjedhjeve ndonëse nuk ishte parashikuar as në buxhetin aktual e as në atë afatmesëm. Një faturë e paparashikuar e cila duhej të gjente burimet e financimit nga arkat e shtetit.

Nga ana tjetër një politikë e re monetare kishte nisur zbatimin që nga 1 Prilli 2023, ajo e rritjes së pagës minimale. Ndryshimi i gjashtë në një dekadë, shifër kjo larg rekomandimeve të institucioneve të BE-së që rekomandojnë në kufinj të dy herëve në katër vite. Kjo vendimmarrje shton kostot në buxhetin e shtetit me financimin ndaj biznesit të diferencës së krijuar nga niveli i mëparshëm i sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për çdo punonjës. Një tjetër faturë kjo që duhet përballuar nga buxheti i shtetit. Në këtë formë qeveria pretendon të ulë barrën e detyrimeve të biznesit vetëm për periudhën tranzitore.

Një politikë e tillë prekë më shumë biznesin e vogël dhe atë të mesëm të cilët kanë edhe numrin më të madh të punonjësve që i përkasin kësaj fashe. Fondi mbrojtës nga buxheti i shtetit mbulon kostot shtesë në detyrime deri në fund të vitit, pra e konsideruar si një periudhë e mjaftueshme tranzitore, por vetëm vazhdimësia do ta tregojë sa do të jenë të aftë këto biznese të mbulojnë vetë kostot shtesë të krijuara nga kjo rritje e pagës minimale.

Realiteti në të cilin po jetojmë dëshmon një rritje të qëndrueshme të inflacionit gjë e cila padyshim kushtëzon qeveritë të ndërmarrin politika të tilla. Pra e thënë ndryshe e ardhur si përgjigje e kushteve të krijuara nga tregu. Një politikë e tillë u marketua si një “bamirësi” nga ana e qeverisë për qytetarët pasi edhe financat kishin arritur pjekurinë e duhur për ta përballuar implimentimet e këtyre ndryshimeve. Nëpërmjet këtij punimi do mundohemi të arsyetojmë faktorët real që kanë ndikuar në ndërmarrjen e këtyre vendimeve dhe si ato do ndikojnë në ekonomi.

## Çfarë është paga minimale?


Paga minimale është një politikë sociale dhe monetare e përcaktuar si shuma minimale e shpërblimit që punëdhënësi ka detyrimin të paguajë punëmarrësin për një periudhë të përcaktuar në Kodin e Punës, e cila nuk mund të reduktohet. Referuar Kodit të Punës paga minimale përcaktohet në bazë të faktorëve ekonomik, shkallës së zvogëlimit të papunësisë si dhe duke analizuar nivelin e përgjithshëm të jetesës së punëmarrësve dhe grupeve të ndryshme shoqërore.

Nisur nga përkufizimi kuptohet natyra detyruese e kësaj politike që bie mbi të gjitha njësitë publike apo private që definohen në kontratën e punës si punëdhënëse. Qëllimi i pagës minimale është karakteri mbrojtës ndaj punëmarrësit si në raport me punëdhënësin ashtu edhe në raport me indikatorët që përcaktojnë kushtet e nivelit të jetesës.

Koncepti i pagës minimale i ka fillimet në vitet 1900 duke u perifrastuar si një masë e përkohshme e cila hiqej gradualisht pasi të negociohej paga mes palëve.<sup>1</sup> Ky koncept evoluoi duke e sjellë atë sot në një masë detyruese mbrojtëse.

## Ecuria e pagës minimale në Shqipëri

Përgjatë këtyre 32 viteve paga minimale në Shqipëri është ndryshuar 22 herë si pasojë e përshtatjes me zhvillimet ekonomike në nivel mikro dhe makro. Duke iu referuar vendimeve publikuara ndër vite konstatohet një rritje progresive e pagës minimale. Deri në vitet 2004 – 2005 rritja e pagës minimale ka qenë pothuajse e pandjeshme. Rritjet më të ndjeshme kanë qënë mes viteve 2005 – 2006 si dhe në tre vitet e fundit.



**Fig. 1 Ecuria e Pagës Minimale marrë nga INSTAT**

Në raportin e fudit, 32,7% e kontribuesve në kategorinë e të punësuarve me pagë marrin një page mesatare mujore bruto deri në nivelin e pagës minimale zyrtare.

<sup>1</sup> [What is a minimum wage: 1.3. A short history](#)



## Vendimi

Që nga 1 Prilli 2023 në bazë të vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.113, datë 1.3.2023 është sanksionuar në pikën një të këtij vendimi ndryshimi i pagës minimale në Shqipëri në nivelin 40 000 lekë, duke shënuar kështu një rritje me 17.6% nga niveli i mëparshëm prej 34 000 lekëve.

Me këtë vendim qeveria shqiptare i përgjigjet situacioneve ekonomike që po kalon vendi, duke theksuar këtu inflacionin apo “krizën e çmimeve”.

Paraqitet shqetësues fakti që paga minimale në Shqipëri ka ndryshuar 6 herë në dekadën e fundit dhe dy herë vetëm në vitin e kaluar, kur në direktivat e BE, sugjerohet 1 deri në 2 herë në 4 vite, kjo për të krijuar qëndrueshmëri dhe përshtatje nga njësitë ekonomike punëdhënëse. Dihet që rritja e pagës minimale është një barrë financiare për bizneset të cilat duhet të gjejnë burimet për ta mbuluar këto kosto të shtuara për to. Problematikë e konstatuar, por edhe e reklamuar nga pala e përfaqësuesve të biznesit ka qënë mungesa e tryezave të diskutimit mes përfaqësuesve të qeverisë dhe të biznesit. Kjo është njehsuar si një vendimmarrje e njëanshme dhe e pakonsultuar.

## Efektet që pasojnë indeksimin e pagës minimale

Rritja e pagës minimale mund të cilësohet si një politikë e cila sjell efekte të shumëfishta të cilat vijnë si rrjedhojë e ndërlikimeve zinxhir të proceseve në ekonomi. Biznesi i madh dhe i mesëm edhe si më të konsoliduar në aspektin monetar kishin ndërmarrë politika të tilla indeksimi të pagave edhe para vendimit të Këshillit të Ministrave. Kjo tregon që një vendim i tillë nuk do të sjellë efekte lidhur me këto nivele të sipërmarrjes.

Ndryshe paraqitet situata lidhur me biznesin e vogël i cili do të jetë ai që do ta ndjejë më së shumti barrën e kësaj politike duke ditur edhe faktin që shumica e të punësuarve me pagë minimale vijnë pikërisht nga ky nivel sipërmarrjeje.

Rritja e pagës minimale me 6 mijë lekë, do të ndikojë edhe në rritjen e kostove të biznesit për pagesën e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore. Nëse i referohemi kufirit të mëparshëm prej 34 000 lekësh, kostot e kontributeve në sigurime shëndetësore përbënin shumën e 1 156 lekëve ndërsa kontributet në sigurimet shoqërore përbënin shumën e 8 300 lekëve, me një total të përgjithshëm prej 9 486 lekësh. Nga kjo shumë Punëdhënësi detyrohej të paguante 3 808 lekë, ose 11.2% të pagës bruto, ndërsa Punëmarrësi 5 678 lekë e barazvlershme me 16.7% të pagës bruto.

Aktualisht me rritjen e kufirit për një pagë prej 40 000 lekë, pagesa për sigurimet shëndetësore është në shumën 1 360 lekë, ndërsa pagesa për kontributet në sigurimet shoqërore është në shumën 9 800 lekë, me një total të përgjithshëm prej 11 160 lekë. Nga kjo shumë Punëdhënësi detyrohet të paguaj 4 480 lekë ose 11.2% të pagës bruto, ndërsa Punëmarrësi 6 680 lekë e cila është e barazvlerëshme me 16.7% të pagës bruto.

Pra në ndryshim nga një vit më parë do të mblidhen nga shteti në formën e kontributeve 18% më shumë sigurime shoqërore apo shëndetësore si rrjedhojë e këtij vendimi. Në këndvështrimin e sipërmarrjes si punëdhënëse në këtë rast do të ketë një rritje prej 18% të kostos së detyrimeve që ajo ka ndaj shtetit në lidhje me pagat minimale. Në terma nominal kostoja për një punonjës që paguhet me pagë minimale do të rritet me 6 672 lekë në këndvështrimin e Punëdhënësit krahasuar me një vit më parë. Në këndvështrimin e punëmarrësit paga minimale neto do të rritet nga 28 322 që ishte në vitin 2022 në 33 320 lekë, pra përkatësisht me 18%.

Referuar VKM-së 114, datë 1.3.2023 qeveria vendosi të subvencionojë bizneset përpunuese, të sektorit të bujqësisë, peshkimit dhe pyjeve në shumën 1 674 lekë për çdo të punësuar me pagë minimale. Shuma totale për çdo kompensim për çdo muaj do të bazohet në numrin e punonjësve, në masën 1,674 lekë për çdo punonjës e llogaritur në referencë edhe të periudhës kontributeve të muajit dhjetor 2022. Aplikuesit nuk duhet të kenë detyrime të papaguara të kontributeve të sigurimeve shoqërore, gjopa të papaguara apo janë në proces falimentimi në të kundërt kërkesa e tyre do të refuzohet.<sup>2</sup> Kjo mbështetje nga qeveria që do të zgjasë për periudhën Prill- Dhjetor 2023 dhe do të mbështetet nga "Fondi i kontigjencës" do të ketë një efekt financiar prej 452 000 000 lekësh në buxhetin e shtetit.

Viti	Paga Bruto Minimale	Punëdhënësi			Punëmarrësi			Paga Neto Minimale
		Sigurime Shoqërore 9.5%	Sigurime Shëndetësore 1.7%	Totali	Sigurime Shoqëror e 15%	Sigurime Shëndetësore 1.7%	Totali	
2022	34 000	3 230	578	3 808	5 100	578	5 678	28 322
2023	40 000	3 800	680	4 480	6 000	680	6 680	33 320

**Fig.2 Shpërndarja e kontributeve të sigurimeve mbi pagën minimale në vitet 2022 dhe 2023**

<sup>2</sup> [Fletorja Zyrtare e Republikës së Shqipërisë Nr. 34, Datë. 01/03/2023](#)

Biznesi i vogël do t'i transferojë këto kosto shtesë pas Dhjetorit 2023 tek çmimet. Pra në fund të këtij rrethi vicioz ai që e pëson është konsumatori dhe sidomos ai konsumator me të ardhura që i përkasin fashës së ulët.

Nga këndvështrimi i punonjësit që paguhet me pagë minimale ndërmarrja e një politike të tillë indeksimi vjen e domosdoshme kur sipas shifrave të INSTAT në muajin prill 2023 inflacioni rezulton në nivelet e 4.6%. Krahasuar me muajin Prill 2022 kemi një indeksim të çmimeve për kategorinë "ushqime dhe pije joalkolike" me afro 9.6%, ku brenda këtij grupi të cilësuar edhe si "produktet e shportës" rezultojnë me një indeksim çmimet e produkteve si qumësht, vezë dhe djathë me afro 15.5%, pasuar nga nëngrupet "peshk" me 13,5 %, "mish" me 12,3 %, "zarzavate përfshirë patatet" me 10,7 %, "fruta" me 7,7 %, "bukë dhe drithëra" me 5,6 %, "sheqer, recel, mjaltë, çokollata dhe ëmbëlsira" me 4,9 %.

Në këto kushte të një realiteti të ri të botës së çmimeve të produkteve bazë dhe të domosdoshme, rritja e pagës minimale vjen si një politikë e thjesht për t'iu përgjigjur inflacionit që ka mbërthyer ekonominë. Padyshim kjo politikë e kushtëzuar e shtyn vendin drejt një realiteti të ri të nivelit të pagave, por kjo nuk vjen e përkthyer në një nivel të ri konsumi. Në terma të thjeshtëzuar qytetarët sot do konsumojnë atë që kanë konsumuar dje me vlerën e të djeshmes, por me çmimin e të sotmes.

## Ndikimi në Buxhetin e Shtetit

Efektet e politikës së indeksimit të pagës minimale kanë ndikim jo vetëm mbi binomin Punëdhënës – Punëmarrës, por edhe mbi element makro, si Buxheti i Shtetit mbi të cilin pasqyrohen efektet e politikave nëpërmjet mbledhjes së të ardhurave që vijnë nga tatimet.

Tatimi mbi të ardhurat personale definon një detyrim tatimor për çdo individ rezident apo jo rezident lidhur me burimet e të ardhurave, të realizuara në territorin e Republikës së Shqipërisë. Në të ardhurat e tatueshme ndër të tjera bëjnë pjesë pagat dhe shpërblimet e tjera të lidhura me marrëdhëniet aktuale të punës.

Indeksi i pagës minimale ka sjellë përveç të tjerash efekte pozitive lidhur me rritjen e të ardhurave të mbledhura në arkën e shtetit.<sup>3</sup>Referuar të dhënave zyrtare nga Ministria e Financave rezulton që janë arkëtuar 18.1 miliardë lekë nga tatimi mbi të ardhurat personale në periudhën Prill 2023. Po ta krahasojmë me po të njëjtën periudhë një vit më parë rezulton një rritje me afro 23.5%.

Duket se kjo vjen edhe si një trend i përsëritur i viteve të fundit sa herë që ndërmerren politika indeksimi lidhur me pagën minimale. Më shumë të


<sup>3</sup> [Përmbledhje e Performancës Paraprake 4 – Mujore të të Ardhurave dhe Shpenzimeve](#)

ardhura në arkat e shtetit nënkuptojnë një buxhet më të fryrë dhe rrjedhimisht më shumë hapësira për investime, apo përkthim në shërbime.

## Ndikimi mbi investimet e huaja

Paga minimale ka qënë një faktor determinant përsa i takon ardhjes së investitorëve të huaj për të investuar në Shqipëri, shtuar këtu edhe pozicionimin gjeografik. Rritja e pagës minimale efektton edhe mbi këto investitorë të cilët janë të ndjeshëm ndaj këtyre kostove, për të cilat ato synojnë që t'i minimizojnë. Pas 1 Prillit 2023 Shqipëria renditet e treta në Ballkanin Perëndimor përsa i takon pagës minimale, duke lënë pas Maqedoninë e Veriut, Bosnje Hercegovinën dhe Kosovën. Kjo politikë indeksimi e pagës minimale mund të ndikojë rritjen e riskut që investitorë të huaj të synojnë vende të tjera të Ballkanit Perëndimor ku edhe paga minimale është më e vogël.

**Fig.3 Paga Minimale në vendet e Ballkanit Perëndimor marrë nga EUROSTAT<sup>4</sup>**



**Burimi: Eurostat**

Kjo ndryshueshmëri e vazhdueshme e vlerës së pagës minimale nuk krijon një terren të favorshëm për investitorët. Paqëndrueshmëri të tilla risin shkallën e riskozitetit në vlerësimet që investitorë të huaj bëjnë përpara se të investojnë në një shtet.

## Numri i të deklaruarve me pagë minimale

Në bazë të kërkesës për informim që Qëndresa Qytetare drejtoi ndaj Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë lidhur me numrin e të deklaruarve me pagë minimale në sektorin publik u cilësua se ndër 84 000 punonjës në total në sektorin publik vetëm 500 prej tyre paguhen me pagë minimale. E thënë ndryshe 0.6% e punonjësve në sektorin publik paguhen me pagë minimale.

<sup>4</sup> [Products Datasets - Eurostat](#)



Nga një politikë e tillë mendohet që përfitojnë rreth 290 mijë punonjës në sektorin publik e privat që do të paguhen me pagë minimale. Shifër kjo që tregon se një pjesë e mirë e të punësuarve përbëjnë ato punonjës që paguhen me pagë minimale.

Nga të dhënat arrijmë të kuptojmë që pjesa më e madhe e të punësuarve me pagë minimalë janë në sektorin privat me një diferencë të konsiderueshme nga sektori publik.

## Ligji i Pagave

Me miratimin në Kuvend të projektligjit “Për pagat, shpërblimet dhe Strukturat e Institucioneve të Pavarura Kushtetuese dhe të Institucioneve të tjera të pavarura të krijuara me ligj”, të ndryshuar” nis një ndryshim tërësor në hierarkinë e pagave në vend. Një politikë e tillë synon të jetë gjithëpërfshirëse dhe të ndikojë pozitivisht në rritjen e nivelit të të ardhura, por nga ana tjetër do t’i sjellë shtetit shqiptar një faturë prej 39 miliardë lekësh. Një vendimmarrje e tillë u ndërmor në zbatim të vendimit nr. 35/2022, të Gjykatës Kushtetuese<sup>5</sup>. Nga kjo reformë përfitojnë rreth 130330 punonjës të sektorit publik.

Efektet financiare pritet të ndihen në dy vitet e ardhshme, kur edhe kjo reformë të konsolidohet. Pikënisjen një politikë e tillë e pati në fushatë elektorale ku edhe u elaborua në takimet e zhvilluara nga Kryeministri. Në pamje të parë një reformë e tillë e këtyre niveleve që përfshin një spektër të gjerë punonjësish është positive, por vlen të analizohen shkaqet që kanë ndikuar në ndërmarrjen e një politike të tillë dhe sa do jetë efekti real i saj.

## Faktorët që ndikuan rritjen

Me termin “ritje” shpesh i referohemi një efekti të matshëm pozitiv në terma real, ndërsa me termin “indeksim” kuptojmë lidhjen e vlerës së diçkaje me ndryshimin e treguesve të tjerë të saj. Nisur nga kjo mund të shtrojmë pytjen në terma konkret a kemi të bëjmë me një “ritje” apo “indeksim” të nivelit të pagave?

Duke iu referuar indikatorëve kryesorë të ekonomisë do arrijmë të kuptojmë shkaqet që çuan në ndërmarrjen e një politike të tillë. Ta nisim analizën me inflacionin, një tregues që orienton edhe konsumin dhe jep një çasje rreth ndryshimit të nivelit të përgjithshëm të çmimeve. Referuar edhe shifrave të INSTAT, inflacioni në periudhën e fundit ka kapur vlerat mesatare 6%, duke regjistruar në harkun kohor të pak muajve edhe shifra historike si pasojë e rritjes.


<sup>5</sup> [për "zbatimin e vendimit nr.35, datë 22.11.2022 të gjykatës kushtetuese"](#)

Një tjetër indikator i rëndësishëm që lidhet drejtpërsëdrejti si me të ardhurat e buxhetit të shtetit, por që shërben edhe si tregues i ndikimit real të rritjes së inflacionit, apo dëshmon mosproporcionalitetin çmime-paga është konsumi. Konsumin mund ta bëjmë të matshëm nëpërmjet treguesve që dëshmojnë të ardhurat e mbledhura nga TVSH-ja. Referuar të dhënave zyrtare të marra nga Ministria e Financave<sup>6</sup> të ardhurat nga TVSH në muajin prill shënuan rënie vjetore me rreth 4%. Ky tregues vjen si rrjedhojë e një trendi në rënie të të ardhurave nga TVSH-ja në tre muajt e fundit, duke dëshmuar kështu efektin e rritjes së nivelit të përgjithshëm të çmimeve.

Këto dy faktorë të ndërlidhur dëshmojnë se reforma e ndërmarrë për ndryshimet e nivelit të pagave ka ardhur e kushtëzuar nga faktorët ekonomik të tregut. Kësaj po t'i shtojmë edhe vendimin për rritjen e pagës minimale, e cila apriori kushtëzon edhe një indeksim të përgjithshëm të pagave për t'ju përgjigjur stadi më të ri të nivelit të pagave. Thënë ndryshe në terma më të thjeshtë kemi të bëjmë me një indeksim që i është bërë pagave si kundërpërgjigje ndaj paqëndrueshmërisë së nivelit të inflacionit, dhe trendit rënës së nivelit të konsumit.

## Efektet reale që sjell

Reforma e pagave u propagandua në diskurin publik si një rritje që vjen në dobi të mbrojtjes së dinjitetit të punonjësit, duke zhvilluar në këtë formë edhe mirëqënien. Shifrat në fakt flasin për një realitet të ndryshëm dhe që bazohet mbi parimin e joproporcionalitetit.



Burimi: Gazeta "Monitor"

<sup>6</sup> [Përmbledhje e Performancës Paraprake 4 – Mujore të të Ardhurave dhe Shpenzimeve](#)

Referuar grafikut të mësipërm arrijmë të cilësojmë se rritjen reale në hierarki e kanë deputetët me afro 91,2%, të ndjekur nga ministrat me 75,7%, Kryeministri së bashku me Kryetarin e Kuvendit me 65,7% e ndërsa në kahun tjetër të profesioneve bazë që nga mjeku i përgjithshëm e deri tek mësuesi rritja reale është në kufinj të 0,3%.

Në masën e gjerë të profesioneve kemi të bëjmë thjesht me një indeksim, në përgjigje të ndryshimeve të kushteve të tregut të çmimeve. Kjo është një politikë e detyrueshme të ndërmerret nga Qeveria, pasi vjen në kushte të një ristrukturimi që tregu i ka bërë kostos së jetesës. Shifrat gjithashtu dëshmojnë disproporcionin e bërë në masën e rritjes së pagës. Në terma nominal masa e rritjes së pagës së deputetit është afërsisht 14 herë më shumë se ajo e një infermieri. Nëse deri në Shkurt të këtij viti paga e një mësuesi ishte sa 32% e pagës së një ministri, sot me ndryshimet e kryera nuk përbën dot as 19%. Kjo politikë po ndikon në ndarjen dhe shtresëzimin e pagave duke krijuar diferenca reale mes shkallëve të sipërme të hierarkisë së pagave me ato të poshtme.

Sektori Publik	Numri i Punonjësve	Indeksi i pagës
Administratës Qendrore	18 000	24-61%
Administratës Vendore	25 000	minimalisht 6,000 lekë
Sistemit Arsimor Parauniversitar	36 570	23-36%
Sistemit Arsimor Universitar	4 237	20% e kufirit minimal të pagës për titull.
Sistemit Shëndetësor	18 858	26-34%
Forcave të Armatorura	6 756	4-22%
Gardës së Republikës dhe Policisë së Shtetit	12 120	7 % për vitin 2023 21-35% në vitin 2024
Policisë së Burgjeve	3 566	7% për vitin 2023 22-36% në vitin 2024
Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit	1 181	7% për vitin 2023 12-40% në vitin 2024
Shërbimit Diplomatik	367	20 %
AKSHI	171	13-49%
Punonjës Mbështetës	9 000	9.3%-17%

Burimi: Kryeministria<sup>7</sup>

<sup>7</sup> [punonjësit përfitues nga reforma e re e rritjes së pagave](#)

## Burimet e financimit të reformës për rritjen e pagave

Në bazë të kërkesës për informim që Qëndresa Qytetare drejtoi ndaj Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë lidhur me burimet e financimit për rritjen e pagave, u cilësua se kjo politikë e rritjes do mbulohej nga fondi i kontigjencës.

Fondi i kontigjencës është një fond pjesë e buxhetit i cili planifikohet të mbulojë shpenzime të paparishkuara që mund të rrjedhin nga ngjarje të papërfshira në buxhet. Qeveria mund ta përdorë këtë fond sipas nevojave të saj për të mbuluar nevoja imediate të lindura të kushte të papërcaktuara.

Referuar Ligjit të Buxhetit 2023 në Nenin 11 të tij parashtrihen zërat e shpenzimeve të parashikuara buxhetore, pjesë e të cilave është edhe fondi i kontigjencës. Në total parashikohet një fond kontigjence 15 500 milionë lekë nga të cilat 2 300 milionë lekë do të përdoren pikërisht për politika të reja pagash. Kjo është shuma nëpërmjet të cilës qeveria do të mbulojë shpenzimet e krijuara për rritjen e pagave.

Ky është një alokim fondesh për një vendim të paparacaktuar, pra të marra nga fonde të ruajtura për situata të paparashikueshme.



## Përfundime:

1. Politika e indeksimit të pagës minimale ndikon drejtpërsëdrejti duke rritur me 18% masën e detyrimeve që ka biznesi ndaj shtetit lidhur me sigurimet ndaj punonjësve. Të prekurat kryesore janë bizneset e vogla dhe të mesme që kanë edhe numrin më të madh të punonjësve me këtë fashë page.
2. Qeveria do të subvencionojë bizneset deri në Dhjetor 2023 për masën shtesë të rritjes së detyrimit të sigurimeve të punonjësve që bizneset kanë ndaj shtetit.
3. Indeksi i pagës minimale është një politikë që favorizon rreth 290 mijë punonjës 500 prej të cilëve i përkasin sektorit publik.
4. Indeksi i pagës minimale në 40 mijë lekë e rendit Shqipërinë të tretën në rajon pas Malit të Zi dhe Serbisë.
5. Indeksi i pagave për disa kategori të sektorit publik u kushtëzua nga niveli i inflacionit i regjistruar përgjatë periudhës së fundit, rënia e treguesve të konsumit si dhe nga indeksi i pagës minimale.
6. Kjo politikë u elaburua në publik në periudhën para zgjedhjeve vendore duke krijuar edhe divergjenca lidhur me vërtetësinë e saj.
7. Ky indeksim do të mbulohet nga fondet e kontigjencës ku në Ligjin e Buxhetit 2023, parashikohet një shumë prej 2300 milionë lekë.

## Rekomandime:

1. Paga minimale në Shqipëri ka ndryshuar 6 herë në dekadën e fundit dhe dy herë vetëm në vitin e kaluar, kur në direktivat e BE, sugjerohet 1 deri në 2 herë në 4 vite. Ndryshime të tilla të vazhdueshme krijojnë paqëndrueshmëri monetare.
2. Vendimi për rritjen e pagës minimale krijon një barrë të re detyrimesh për biznesin e vogël dhe të mesëm që përbëjnë edhe kolonat e tregut, prandaj do ishte dashur më shumë diskutim me grupet e interesit për një politikë të tillë që ka efekt kaq të gjerë.
3. Rritja e pagës minimale duke u renditur të tretët në rajon padyshim favorizon punonjësit, por mund të ndikojë në uljen e Investimeve të Huaja Direkte (IHD) të cilët mund të preferojnë të çojnë investime në vende ku paga minimale e punonjëse është më e ulët dhe ka kosto më të ulët të “krahut të punës”.
4. “Rritja” e pagave në sektorin publik ka disbalanca të theksuara mes kategorive nëse normën e rritjes e indeksojmë me vlerën e inflacionit. Qeveria do duhej të ruante më shumë balancat lidhur me efektet që rritjet sjellin në ekonomi.

## Bibliografia:

FLETORJA ZYRTARE. (2023, March 02). Ministria e Financave dhe Ekonomisë. ([Fletorja Zyrtare e Republikës së Shqipërisë Nr. 34, Datë. 01/03/2023](#))

Përmbledhje e Performancës Paraprake 4 – Mujore të të Ardhurave dhe Shpenzimeve. (2023, May 18). Ministria e Financave dhe Ekonomisë. ([Përmbledhje e Performancës Paraprake 4 – Mujore të të Ardhurave dhe Shpenzimeve](#))

Minimum wages. (2023, March 13). EUROSTAT. ([Products Datasets - Eurostat](#))

VENDIM Nr.49 për zbatimin e vendimit Nr.35, Datw 22.11.2022 tw Gjykatws Kushtetuese. (2023, February 23). Këshilli i Lartë i Prokororisë. ([për “zbatimin e vendimit nr.35, datë 22.11.2022 të gjykatës kushtetuese”](#))

PUNONJËSIT PËRFITUES NGA REFORMA E RE E RITJES SË PAGAVE. Kryeministria. ([punonjësit përfitues nga reforma e re e rritjes së pagave](#))

Ligji i Buxhetit 2023. (2023). Ministria e Financave dhe Ekonomisë. ([Buxheti 2023](#))

Çfarë është paga minimale?. Organizata Ndërkombëtare e Punës. ([What is a minimum wage: 1.3. A short history](#))

Zv.ministrja e financave: Në maj, 290 mijë punonjës do të marrin 40 mijë lekë. (2023, March 01). Shqiptarja.com. ([Rritet paga minimale/ Zv.ministrja e financave për Report TV: Në maj, 290 mijë punonjës do të marrin 40 mijë lekë! Ja pse u mor ky vendim - Shqiptarja.com](#))

Ecuria e Pagës Minimale. (2023). INSTAT. ([Pagat | Instat](#))

Reforma e pagave thellon pabarazinë. (2023, May 24). Gazeta MONITOR. ([Reforma e pagave thellon pabarazinë, mësuesit, mjekët dhe infermierët rritje reale 0%, deputetët dhe ministrat deri në 90% - Revista Monitor](#))

#QËNDRESË / MIRËQEVERISJE

QENDRESA  
QYTETARE



NATIONAL  
ENDOWMENT  
FOR  
DEMOCRACY

SUPPORTING FREEDOM AROUND THE WORLD

[www.qeverisja.qq.com.al](http://www.qeverisja.qq.com.al)